

Menaxhimi i tufës

Përgatitur nga Dr. Gabriele Wetchy, Instituti i Inseminimit Wieselbur/Austria dhe nje ndër specialistët më të mirënjohur për transferimet embrionale.

Lopët nga periudha e tharjes, deri në ndërzimin e radhës

Lopët në periudhën e tharjes: Periudha e tharjes nuk është fundi i laktacionit por fillimi i laktacionit tjetër. Koha e tharjes është themeli i laktacionit të ardhshëm.

Në fund të fazës së laktacionit është i domosdoshëm një trajtim funksional i thundrave tek lopët e qumështit. (Shkaktojnë anoreksi – çrregullim të metabolizmit si dhe rënie të intensitetit të afshit)

Periudha para tharjes: Kontroll i imtësishëm i gjirit dhe kontroll i ndryshimeve të qumështit (probleme me mastitis), prekje e gjirit për evidentimin e problemeve sipërfaqësore si dhe implementimi i Shalmtest, ndryshime në viskozitetin e qumështit. Matje e PH-shit (Phenolphthalein) Mastiris.

Kurshfaqen probleme : Kalimi i lopëve në tharje nëpërmjet trajtimit me antibiotikë, preparate tharje me përbërje antibiotiku direkt në indin e gjirit. Ky trajtim shëron infeksionet ekzistuese dhe parandalon formimin e infeksioneve të reja. Gjatë periudhës së tharjes duhet një kontroll optik i vazhdueshëm për mastitis (minimalisht një herë çdo javë), kontroll i të ushqyerit dhe kushteve fizike të kafshës.

Kohëzgjatja e tharjes: 6 deri 8 javë. Është e rëndësishme të monitorohen të dhënat e inseminimit.

Periudhë e gjatë e tharjes: Kondicioni truporë shumë i mirë/dhjamose. Shkakton probleme gjatë lindjes, çrregullime në metabolizmin e mëlçisë dhe si pasojë probleme të fertilitetit.

Periudhë e shkurtër e tharjes: Nuk është i mundur regjenerimi i plotë i gjirit, ndikon në ulje e rendimentit të qumështit dhe në cilësinë e kullostrës.

Periudha e mjaftueshme e tharjes për lopët e qumështit është 6 javë por lidhet ngushtë me sasinë e domosdoshme të racionit ushqimorë të përshtatur në kërkesat e kafshës si dhe me sasinë e mjaftueshme të ujit gjatë gjithë kohës. Gjatë periudhës së tharjes duhet të tregojmë vëmendje që të mos ketë rënie në peshë apo dhjamose të trupit të lopës. Rregulli për llogaritjen e racionit për këtë fazë është: Nevoja për mirëmbajtje plus për prodhimin e 5-8 kilogramë qumësht, natyrisht me cilësi të lartë.

Kafshët në fund të laktacionit janë të dhjamosura nuk duhet të kalohen menjëherë në uri (dobësim)! Shenjat e acidozës subklinike përpara pjelljes bëhen më të dukshme pas kësaj periudhe.

Racioni ushqimor duhet të llogaritet nga specialisti i të ushqyerit. Llogaritja e racionit për laktacion duhet të përshtatet sa më herët. Rekomandohet 2-3 javë para pjelljes. Ushqimi duhet të jetë i pasur me celulozë dhe sasia e koncentratit duhet të shtohet pak e nga pak (0,5 kg çdo ditë). Mikroflora e plëndësit duhet të adoptohet me racionin ushqimor të llogaritur për lopët në laktacion me energji të lartë. Ndryshimi i menjëhershëm i ushqimit sjell probleme me thundrat dhe zhvendosje të abomazit.

Lopët mbas pjelljes

Monitorim intensiv i kafshës:

Sjellja gjatë të ushqyerjes

Ripërtypja

Qëndrimi trupor

Sekrecionet

Në qoftë se vëreni diçka duhet të kryeni ekzaminime në klinikë dhe duhet të matni temperaturën e brendshme (IKT)

↓

IKT është normale

Probleme në metabolizëm

Një herë kortizon

Infuzioni glukozë dhe kalcium deri sa kafshës t'i rikthehet oreksi dhe mos të ketë më probleme me tretjen dhe zhvendosjen e abomazit.

↓

IKT e lartë = ethe

Kërkoni për shkaqet

Tufë e infektuar: Mastitis në gji, ulterus, abdomenin, mushkëritë
Aplikimi i medikamenteve për uljen e temperaturës, si: antibiotik, kortizon dhe infuzione me kalcium dhe glukozë.

↓


Parandalimi i dëmtimit të mëlçisë, problemeve të thundrave, rikthimi i oreksit, rehati maksimale për lopën.
Trajtim individual i kafshëve të sëmura

Qëllimi: Diagnostifikim i shpejtë dhe i saktë i lopëve të sëmura. Lopët të cilat kanë probleme do të kontrollohen tërësisht.

Lopët pas pjelljes:

Problemet me placentën pas pjelljes:

Në qoftë se placenta nuk është hequr 12 orë pas pjelljes:



Monitorimi i kafshës:

Koka: Shikoni veshët- Janë të varur apo janë vigjilent për atë çfarë ndodh rreth lopës?
Aromë acide në frymënxjerrjen e lopës? (Çrregullim i metabolizmit të glukozës në në mëlçi)
Gojë e thatë dhe sekrecione të hundës: ethe dhe çrregullime të metabolizmit.

Vulva, bishti, pjesa e daljes së jashtëqitjes: Bishti ngjitet nga rrjedhjet e qafës së mitrës, diare ose jashtëqitje e fortë. Mbetje të dukshme pas pjelljes, lëndime gjatë pjelljes, enjtje, sekrecione të cilat mbajnë erë.

Barku: Mbushje e pakët e rumenit, gropa për tretjen e ushqimit në stomakun rënë, stomaku tërhequr, tërheqje e lartë e tavanit të stomakut.

Kripëra acidike - Profilaksi e etheve të qumështit

Gjatë periudhës së pjelljes kemi një ulje të nivelit të kaliumit në metabolizëm. Problemet me nivelin e mineraleve në organizmin e lopëve sjellin sëmundje klinike dhe subklinike, uljen e konsumit dhe si pasojë probleme me ketozën.

Gjatë kohës së tharjes:

Trajtimi me kalium duhet të ulet rreth 40 gramë për lopë çdo ditë.

Vitamina D3 një herë në javë, maksimalisht 7 copë, minimalisht 3 ditë më parë.

Infuzion me kalium menjëherë mbas lindjes.

Kripëra acidike = kripëra anionike 10–14 ditë, mbetje të një acidi të fortë (Cl, SO₄) dhe me një bazë të dobët (Ca, Mg, NH₄), kripë e athët dhe CASO₄. Niveli i pH në gjak bie si pasojë aktivizohet parahormoni (Parathormon)

Periudha e lindjes:

Boksi i pjelljes duhet të jetë i pastër dhe të ketë fushëpamje të mjaftueshme.

Rregullimi i artë për ndihmën e parë gjatë pjelljes është të ndërhyet në kohën e duhur. Tek gjedhi duhet të jepet ndihma e parë rreth 2-3 orë pas plasjes së placentës. Të shikohet me kujdes drejtimi i tërheqjes së viçit dhe të përdoret një analog për ndihmë gjatë lindjes.

Duhet të kemi kujdes të veçantë kur shfaqen simptoma pafuqie: E shpeshtë tek lopët e shëndosha/dhjamosura.

Mungesë të kalciumit:

Probleme me përmbajtjen e dioksidit të karbonit në metabolizëm (acetoanemi, rrezik i humbjes së kafshës)

Terapia: Trajtimi me kalcium dhe okitocinë. Duhet të pritet zhvillimi i viçit dhe për dhimbjet e lindjes.

Higjena është e domosdoshme: Litarët për ndihmën gjatë pjelljes duhen disinfektuar si dhe është e domosdoshme higjena e vulvës.

Shëndeti i viçi mbas pjelljes:

Sekrecionet tek viçi duhet të pastrohen vetëm tek kurrizi i hundës. Gjatë ndihmës së lindjes duhet të keni kujdes që mos të prekni viçin me gishta tek goja (rrezik për infeksione). Preni kordonin e kërthizës së viçit në mënyrë që mos të kemi probleme me grumbullimin e gjakut në kërthizë. (Ky grumbullim i gjakut ushqen bakteriet, infeksionet e kërthizës, diarenë dhe mund të çojë deri në paralizimin e viçit).

Është e domosdoshme disinfektimi i kërthizës më jodë ose medikamente me përmbajtje antibiotiku.

Viçit duhet ti jepet sa më shpejt kulloshtira e lopës nga kova ose me bebiron.

Është e rekomanduar që viçi të ndahet nga lopa dhe të çohet në një boks të pastër për viça. Ai duhet të ushqehet të paktën një javë me kulloshtër. Në qoftë se një lopë e re që ka pjellë nuk ka mjaftueshëm kulloshtër atëherë ngrini kulloshtër nga lopë të vjetra dhe më pas shkrijeni me ujë të ngrohtë në temperaturë nën 40 °C.

Problemet me diarenë:

(Shikoni artikullin “Viçi jonë ka diare”, Nr. 6)

Përveç medikamenteve të listuar në këtë artikull, viçit duhet t`i japim shtesë Vitamina B – Kompleks, Vitamina E – Se, Vitaminë A. Në qoftë se diarea (virusi Rota – Korona) është e shpeshtë tek viçat e sapolindur ekziston mundësia e vaksinimit të lopës mëmë në periudhën e tharjes.

Problemet e mëlçisë:

1.2% deri 1.5% e peshës trupore, kapaciteti i rezervave dhe mundësia e rigjenerimit është e lartë. Sëmundjet e mëlçisë bëhen të dukshme vetëm në stadin klinik.

Sindroma e përqëndrit të dhjamt.

Preken sidomos lopët të cilat konsumojnë më tepër ushqim energjik gjatë periudhës së tharjes dhe laktacionit të hershëm ose kur ka mungesë të energjisë dhe tepëri të proteinave.

Si pasojë e mbi dhjamosjes kemi: probleme në lindje, probleme pas lindjes, zhvendosje e abromazit si dhe reduktim i konsumit të ushqimit.

Më pas kemi probleme me thundrat dhe fertilitetin (afsh i fshehtë, endometritis, ciste, cikël i çrregullt, rënie e propabilitetit të inseminimit)

Shkaqet:

Ketozë primare ose ocetoanemie.

Ka të bëj me nivelin e karbohidrateve në metabolizëm.

Si pasojë e mungesës të glukozës dhe përqëndrimit të dhjamt në trup, kemi një bilanc negativ të energjisë.

Metabolizmi i mëlçisë ndikon thuajse tek të gjithë organet e tjera.

Rendimenti bie gradualisht, niveli i yndyrnave në qumësht është normal ose i lartë.

Kemi rënie të peshës trupore, mungesë të oreksit si dhe kafsha në fillim preferon më parë ushqimin energjik.

Kafsha kalon një gjendje lodhjeje, mungesë të elasticitetit të lëkurës, qime të ashpra, probleme gastrointenciale me diarenë deri tek jashtëqitje në formë topi të thatë dhe të zezë të mbuluar me mukozë.

Takikardi dhe IKT normale.

Edemë, ascite, rënie e funksionit të mëlçisë.

Enzimata e mëlçisë.

Sekcione të mëlçisë: e fryer, e verdhë, e brishtë e dhjamosur e degraduar.

Ketozë sekondare:

Shkaktohet nga sëmundje të tjera, shpesh herë nga infeksionet (Problemet me thundrat, pneumoni etj). Mund të shkojë deri në bllokim të mëlçisë.

Shkaqe elementare:

Të gjitha mikroelementet të marra nga ushqimi dhe nga arteria kryesore e mëlçisë, ushqyerje e uresë dhe të silazhit jociësor me përmbajtje të acidit butik.

Kur gjendja e lopës mbas pjelljes është normale

- Heqja e placentës 6 - 12 orë mbas pjelljes
- Qafa e mitrës nuk është e sëmurë

- Mitra mbas 3 javësh është po aq e madhe sa përpara inseminimit

Kur lopa mbas pjelljes ka shenja sëmundje

- Placenta nuk është hequr edhe mbas 24 orëve pas pjelljes.

Shkaqet: Mungesë e kalciumit, mungesë e celulozës së papërpunuar, konsum i tepërt gjatë periudhës së tharjes, lindja e viçave binjakë, lindje të parakohshme, lindje problematike.

Terapia: Implementimi higjenik i shkopave me përmbajtje antibiotiku në mitër.

Pastrimi manual mund të kryhet vetëm në qoftë se është e mundur. Injektimi i prostaglandinës 10 - 12 ditë pas pjelljes.

Qafa e mitrës e sëmurë mbas pjelljes.

Ndodh në rast kur vonohet largimi i placentës ose nuk kur nuk hiqet fare, kur mungon kontraktimi i mitrës dhe kur nuk bëjmë kujdes me higjenën gjatë ndihmës së lindjes.

Terapia: Trajtimi me prostaglandinë në ditën e 10-të ose të 12-të pas lindjes, trajtimi i përgjithshëm me antibiotik, përdorimi i panxharit në racionin ushqimor dhe trajtimime kalcium.

Problemet e shfaqura para dhe pas pjelljes shkaktohen kryesisht nga çrregullime të mineraleve dhe energjisë në metabolizëm.